



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

N J O F T I M

Për procedurën e regjistrimit në konkursin e pranimit në programin e studimit "Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte" për vitin akademik 2021-2022 në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Njoftohen të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të ndjekin studimet në programin e studimit "Bachelor në Edukim Fizik dhe Sporte" në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", (që kanë plotësuar detyrimet e maturës shtetërore për regjistrim në QSHA), do t'i nënshtrohen konkursit të pranimit që do të zhvillohet nga data 18-20 gusht 2021.

Regjistrimet për konkursin e pranimit bëhen nga data 10.08.2021 deri më datë 17.08.2021 nga ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰.

Për regjistrim kandidati duhet të dorëzojë në sekretari këto dokumente:

- 1- Fotokopje a pasaportës ose kartës së identitetit.
- 2- Kartelet (Skeda shëndetësore)
- 3- Fotografi 4x6 (dy copë)
- 4- Mandat pagese prej 5000 lekë.

Formulari për arkëtim do të tërhiqet në Sekretarinë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Kur kandidati dorëzon mandat pagesën atij i jepen këto dokumente:

- Rregullore e konkurrimit
- Norma e pranimit
- Skeda shëndetësore